


Tregtia e jashtme e mallrave

Dhjetor 2020

Tiranë, më 18 Janar 2021: Në Dhjetor 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 23 mld lekë, duke u rritur me 5,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 15,6 %, në krahasim me Nëntor 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 61 mld lekë, duke u rritur me 10,5 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 10,1 %, në krahasim me Nëntor 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 38 mld lekë, duke u rritur me 13,9 %, krahasuar me Dhjetor 2019 dhe me 34,8 %, në krahasim me Nëntor 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%), Dhjetor 2020




Gjatë vitit 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 272 mld lekë, duke u ulur me 9,0 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 605 mld lekë, duke u ulur me 6,8 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 333 mld lekë, duke u ulur me 4,9 %, krahasuar me vitin 2019.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Dhjetor 2020, rritja e eksporteve prej 5,4 %, krahasuar me Dhjetor 2019, është ndikuar nga grupet: "Materiale ndërtimi dhe metale" me +6,3 pikë përqindje, "Makineri, paisje, pjesë këmbimi" me +2,8 pikë përqindje, "Ushqim, pije, duhan" me +1,7 pikë përqindje. Në uljen vjetore të eksporteve kanë ndikuar grupet: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -6,3 pikë përqindje, "Lëkurë dhe artikuj prej tyre" me -0,2 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Dhjetor 2020




Eksportet, gjatë vitit 2020 janë ulur me -9,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve janë: “Tekstile dhe këpucë” me -5,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,5 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1,2 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +0,5 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Dhjetor 2020, rritja e importeve prej 10,5 %, krahasuar me Dhjetor 2019 është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,1 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +3,0 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,7 pikë përqindje. Në uljen vjetore të importeve ka ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me -0,8 pikë përqindje dhe “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,5 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Dhjetor 2020



Gjatë vitit 2020, importet janë ulur me 6,8 %, krahasuar me vitin 2019. Grupet që kanë ndikuar kryesisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,8 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Produkte kimike dhe plastike” me +0,4 pikë përqindje dhe “Ushqim, pije, duhan” me +0,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Dhjetor 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Dhjetor 2019 janë: Italia (4,8 %), Kosova (21,1 %) dhe Greqia (6,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Spanja (61,4 %), Gjermania (10,2 %) dhe Mali i Zi (15,1 %).

Gjatë vitit 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë janë: Gjermania (12,8 %), Greqia (3,4 %) dhe Maqedonia e Veriut (3,4 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (13,7 %), Kosova (12,0 %) dhe Spanja (30,4 %).

Në muajin Dhjetor 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Dhjetor 2019 janë: Italia (19,1 %), Greqia (42,1 %) dhe Kina (1,0 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Turqia (9,4 %), Gjermania (0,4 %) dhe SHBA (7,1 %).

Gjatë vitit 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë janë: Greqia (0,2 %), Gjermania (0,3 %) dhe Serbia (77,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (7,4 %), Turqia (6,2 %) dhe Kina (9,5 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Dhjetor 2020



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 61,3 %, të gjithë tregtisë. Në Dhjetor 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 68,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,1 %), Turqia (8,2 %), Greqia (7,9 %) dhe Kina (7,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për vitin 2020, me vendet e BE-së zënë 63,1 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Dhjetor 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 74,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,4 %), Greqia (7,7 %), Gjermania (7,1 %) dhe Turqia (7,0 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Dhjetor 2020

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	10 - 18	30	21,3	58	1,2	-28	51,7
	11 - 18	27	7,0	56	2,7	-29	48,4
	12 - 18	22	-1,6	60	-1,2	-38	36,0
	Janar – Dhjetor 18	310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	09 - 19	25	-4,9	52	2,3	-27	47,8
	10 - 19	27	-10,2	59	1,8	-32	45,6
	11 - 19	25	-9,0	53	-5,6	-28	46,7
	12 - 19	22	1,2	56	-7,6	-34	39,4
	Janar – Dhjetor 19	299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	09 - 20	25	1,3	52	0,5	-27	48,2
	10 - 20	27	-0,5	59	0,1	-32	45,3
	11 - 20	27	10,6	56	5,2	-28	49,1
	12 - 20	23	5,4	61	10,5	-38	37,6
	Janar – Dhjetor 20	272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Dhjetor 2020

	Eksporte				Importe			
	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Jan. - Dhj. 2019	Jan. -Dhj. 2020	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Jan. - Dhj. 2019	Jan. -Dhj. 2020
Vendet e BE-së	16.731	15.912	228.052	203.177	31.360	35.900	373.649	350.752
Austri	107	144	1.790	1.654	530	612	6.830	5.832
Gjermani	1.004	901	14.190	16.008	4.726	4.708	46.482	46.601
Greqi	1.010	1.079	12.781	13.211	3.916	5.564	54.336	54.454
Itali	9.396	9.849	143.105	123.510	13.100	15.608	164.188	151.978
Spanjë	3.255	1.255	23.845	16.601	1.211	867	11.534	9.788
Kroaci	91	110	1.119	1.774	779	452	7.219	6.143
Të tjera të BE-së	1.869	2.574	31.221	30.419	7.097	8.090	83.060	75.957
Mbretëri e Bashkuar	60	58	738	757	545	520	5.641	5.125
Kinë	347	613	6.211	5.003	5.259	5.309	59.727	54.038
Kosovë	2.205	2.672	29.812	26.247	602	863	7.735	8.305
Maqedonia e Veriut	728	862	8.567	8.855	736	931	8.571	9.074
Rusi	0	10	75	23	1.129	913	11.617	13.513
SHBA	254	344	3.667	3.252	1.197	1.112	12.338	9.401
Turqi	140	626	2.055	3.073	6.966	6.312	61.798	57.943
Ukrainë	15	36	172	392	267	250	3.016	4.008
Zvicër	53	10	897	631	942	976	15.337	10.228
Të tjera	1.369	1.946	18.547	20.544	6.520	8.283	89.690	82.874
Gjithsej	21.902	23.088	298.792	271.955	55.524	61.369	649.118	605.262

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Dhjetor 2020

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Jan.- Dhj. 2019	Jan.- Dhj. 2020	Dhjetor 2019	Dhjetor 2020	Jan.- Dhj. 2019	Jan.- Dhj. 2020
Gjithsej	21.902	23.088	298.792	271.955	55.524	61.369	649.118	605.262
Ushqime. pije. duhan	2.876	3.250	35.374	39.050	10.265	9.848	110.365	110.927
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	4.691	3.308	50.274	39.915	6.127	6.617	77.235	54.552
Produkte kimike dhe plastike	480	587	7.653	7.409	7.793	9.456	88.729	91.016
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	161	120	2.444	1.811	1.249	961	17.329	12.631
Prodhime druri dhe letre	738	744	9.592	8.643	1.891	2.352	25.818	24.006
Tekstile dhe këpucë	7.893	7.964	118.202	102.344	6.901	7.150	87.203	75.457
Materiale ndërtimi dhe metale	3.263	4.648	45.385	41.809	5.464	7.168	78.441	78.259
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	1.126	1.743	20.892	22.396	13.299	14.808	138.753	133.820
Të tjera	674	724	8.976	8.577	2.535	3.008	25.244	24.595

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Dhjetor 2020

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	143.105	123.510	29.812	26.247	23.845	16.601	14.190	16.008
Ushqim. pije duhan	8.651	9.699	3.739	4.076	1.249	1.370	1.672	1.818
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	4.967	1.232	6.768	4.889	19.844	13.697	839	1.436
Produkte kimike dhe plastike	2.021	2.017	2.144	2.199	50	103	70	64
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.071	1.592	5	10	212	71	13	31
Prodhime druri dhe letre	6.340	5.263	913	778	4	4	182	349
Tekstile dhe këpucë	91.906	77.003	115	146	2.273	1.100	7.539	8.628
Materiale ndërtimi dhe metale	13.451	12.718	13.613	11.824	198	204	1.591	1.066
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	9.936	10.379	751	803	8	30	1.492	1.912
Të tjera	3.763	3.608	1.763	1.522	6	22	792	702

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë) , Dhjetor 2020

	Itali		Turqi		Greqi		Kina	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Gjithsej	164.188	151.978	61.798	57.943	54.336	54.454	59.727	54.038
Ushqim. pije duhan	19.540	19.906	5.529	5.408	15.764	15.853	803	805
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	7.630	6.645	7.192	3.487	11.097	10.069	8	7
Produkte kimike dhe plastike	18.688	19.720	8.096	8.697	7.750	7.999	5.562	5.546
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	13.736	10.277	270	295	30	35	766	560
Prodhime druri dhe letre	6.920	5.744	3.369	2.994	3.534	3.675	1.061	846
Tekstile dhe këpucë	40.683	33.354	18.126	16.306	3.689	3.744	11.796	10.115
Materiale ndërtimi dhe metale	18.972	18.117	10.361	9.676	8.229	8.564	9.021	6.215
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	32.438	32.928	6.756	8.522	2.711	2.912	24.796	24.313
Të tjera	5.581	5.285	2.098	2.558	1.530	1.602	5.915	5.631

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri